



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 1032/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Zh... N.T.SH, me numër unik identifikues ... dhe seli në ..., Komuna e Gracanics, ..., kundër debitorit Z... B.I, i cili operon nën emrin tregtar N.T L..., me numër unik identifikues ... dhe seli në ... Prishtinë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 295/21, i lejuar me datë 10.08.2021, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Z...” B.I, me numër unik identifikues .., ashtu që ANULOHET Urdhri përmbartimor P.nr. 295/21, i lejuar me datë 10.08.2021, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, faturës nr. 822, e datës 30.09.2015, ka lejuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 295/21, të datës 10.08.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 400.0, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbartim, duke theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi është e parashkuar në kuptim të nenit 352 dhe 354 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve. Gjykatës i

ka propozuar që ta aprovoj në tërësi si bazuar prapësimin, ndërsa urdhri përmbarrimor të shfuqizohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje “LPP”) dhe nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet, ndërsa procedura përmbarrimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata, ka shqyrtuar pretendimet e debitorit në raport me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe gjeti se fatura nr. 822, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarrimi, është lëshuar me datë 30.07.2015, arritshmëria për pagesë e së cilës është caktuar në afat prej 15 ditësh nga data e lëshimit të faturës, përkatësisht e njëjta është bërë e arritshme me datë 14.08.2015, ndërsa propozimi për përmbarrim në raport me këtë faturë është paraqitur me datë 31.08.2021. Rrjedhimisht, fatura e lartcekur është përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: *“...prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarrues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor, është e përfshirë në parashkrim, dhe si i tillë nuk mund t’i nënshtrohet përmbarrimit,

rrjedhimisht edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 dhe 73 të LPP-së, nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1032/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.